



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË FONDIT PËR SIGURIME SHËNDETËSORE PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Fondit për Sigurime Shëndetësore për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Fondit për Sigurime Shëndetësore (FSSH), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Fondit për Sigurime Shëndetësore, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Fondit për Sigurime Shëndetësore kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- B1 38 aplikime, në vlerë të përbashkët prej 876,032€, kanë qenë subjekt i vonesave në trajtimin nga Bordi që nga viti 2021, po ashtu, lëndë me vendime të Bordit që nga viti 2019, të cilat nuk ishin ekzekutuar financiarisht.
- B2 Në 24 raste në vlerë 738,786€, kemi vërejtur që lëndët ishin të pa kompletuara me dokumentacionin e nevojshëm që nga viti 2020 dhe nuk ishin trajtuar nga Bordi për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryesues i Bordit Drejtues të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit për Sigurime Shëndetësore.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Fondit për Sigurime Shëndetësore është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Fondit për Sigurime Shëndetësore në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Fondit për Sigurime Shëndetësore me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Fondit për Sigurime Shëndetësore.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm janë përditësimi i regjistrit dhe shpalosja e detyrimeve kontigjente dhe atyre me fletëzotime, si dhe vlerësimi i regjistrit të pasurive kapitale.

Sa i përket pajtueshmërisë, janë evidentuar vonesa në trajtimin e lëndëve nga Bordi si dhe pranimi i aplikacioneve pa dokumentacion mbështetës të kompletuar.

Ky raport ka rezultuar me kater (4) rekomandime, prej tyre dy (2) janë rekomandime të reja, dhe dy (2) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B1 - Vonesa në ndërmarrjen e veprimeve lidhur me shqyrtimin e lëndëve nga Bordi për lëndët e kompletuara me faturë

Gjetja

Udhëzimi Administrativ (UA) 03/2017, për Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike (TMJISHP), si dhe UA 03/2023 për periudhën pas shtatorit 2023, divizioni për TMJISHP kontrollon aplikacionin në lidhje me përmbajtjen dhe korrektësinë e dokumentacionit të bashkangjitur gjatë aplikimit para se të shqyrtohen nga Bordi dhe pas kompletimit të lëndës e dërgon për aprovim në Bord. Bordi duhet të bëjë shqyrtimin dhe të marrë vendimet për lëndët që kërkojnë trajtim mjekësor jashtë institucioneve brenda afateve dhe në përputhje me kompetencat e përcaktuara.

Nga analiza e aplikimeve të trajtuara është konstatuar se një numër i konsiderueshëm i tyre kanë mbetur në pritje të shqyrtimit dhe vendimmarrjes nga Bordi për periudha të gjata kohore. Sipas evidencave të prezantuara nga institucioni, në vitin 2021 kanë mbetur në pritje dy (2) aplikime, në vitin 2023 një (1) aplikim, në vitin 2024 nëntë (9) aplikime, ndërsa në vitin 2025 tre (3) aplikime, në vlerë totale prej 392,381€.

Kjo situatë tregon për vonesa në procesin e shqyrtimit dhe vendimmarrjes nga Bordi, duke ndikuar në efikasitetin dhe trajtimin me kohë të aplikimeve të parashtruara.

Po ashtu, gjatë testimeve të kryera lidhur me lëndët e aprovuara me vendime të Bordit, është konstatuar se një numër i konsiderueshëm i tyre vazhdojnë të mbeten në pritje, si pasojë e mosndërmarrjes së veprimeve të mjaftueshme për trajtimin e tyre. Vlera totale e këtyre lëndëve arrin në 483,651€.

Sipas evidencave të prezantuara nga institucioni, këto raste kanë mbetur të hapura për periudha të konsiderueshme kohore pas aprovimit nga Bordi.

- në vitin 2019 kanë mbetur të pa ekzekutuara shtatë (7) lëndë me vendime të Bordit;
- në vitin 2022 është evidentuar një (1) lëndë me vendim në pritje të pagesës;
- në vitin 2023 janë evidentuar tre (3) lëndë me vendime në pritje të pagesës;
- në vitin 2024 janë evidentuar pesë (4) lëndë me vendime në pritje të pagesës; dhe
- në vitin 2025 janë evidentuar tetë (8) lëndë në pritje të pagesës me vendime të Bordit.

Sipas UA-së, njëra nga detyrat e Divizionit për TMJISHP është publikimi në ueb-faqen zyrtare të Fondit i radhës së shqyrtimit të aplikimeve nga ana e Bordit për TMJISHP. Megjithatë, gjatë vitit 2025 nuk është aplikuar një praktikë e tillë, duke pamundësuar ndjekjen e procesimit të lëndëve sipas afatit të aplikimit.

Kjo situatë ka ardhur si pasojë e mungesës së një mekanizmi efektiv për ndjekjen dhe monitorimin e ekzekutimit të vendimeve të Bordit, si dhe

vonesave në procedurat e brendshme administrative dhe financiare pas miratimit të tyre. Gjithashtu, është evidentuar mungesë e koordinimit të mjaftueshëm ndërmjet njësive përgjegjëse për përgatitjen e lëndëve, dhe sektorit financiar, si dhe mosveprim në kohë për priorizimin dhe realizimin e pagesave të vendimeve të aprovuara.

Ndikimi

Këto mangësi kanë ndikuar në akumulimin e lëndëve të pa ekzekutuara dhe në zgjatjen e periudhës së pritjes. Po ashtu, mos trajtimi me kohë i lëndëve mund të ndikojë që institucionet shëndetësore jo-publike të hezitojnë në ofrimin e shërbimeve në të ardhmen, kur mbështeten vetëm në fletëzotime. Kjo praktikë mund ta ekspozojë FSSH-në ndaj padive gjyqësore, duke rezultuar në shpenzime shtesë gjyqësore dhe përmbarimore, si dhe në krijimin e obligimeve shtesë për vitin vijues.

Rekomandimi B1

Bordi Ekzekutiv dhe Drejtori i Fondit, duhet të ndërmarrin hapat e nevojshëm në mënyrë që lëndët e kompletuara të trajtohen brenda afatit të përcaktuar. Për rastet tek të cilat ka paqartësi, të ndërmerren hapat e nevojshëm për sqarimin e tyre në mënyrë që të pastrohen regjistrat.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B2 - Lëshim i fletëzotimeve në mungesë të aplikacioneve të plota sa i përket pro-faturave si dhe pranimit të aplikacioneve pa dokumentet e kërkuara

Gjetja

Sipas Udhëzimit Administrativ (UA) Nr. 03/2023 të (MSH) për Trajtimin Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike (TMJISHP), neni 4, pika 4.4, kërkohet paraqitja e tri pro-faturave nga institucione shëndetësore të ndryshme, në rastet kur nuk ekzistojnë çmime referente për diagnozat e përcaktuara në këtë udhëzim. Ky rregull zbatohet për rastet e rregullta dhe ato urgjente. Po ashtu, Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2017, që mbulonte rastet para hyrjes në fuqi të UA të ri, neni 4, pika 3.4, kërkonte paraqitjen e dy pro-faturave nga institucione shëndetësore të ndryshme. Gjithashtu neni 4.5 e UA Nr 03/2023 përcakton se aplikacioni i kompletuar duhet të dorëzohet në Divizionin për TMJISHP, me ç' rast lëshohet fletëdëshmia e aplikimit. Tutje pika 6 i po të njëjtit nen, sqaron se divizioni për TMJISHP nuk duhet të pranojë aplikacione të pakompletuara.

Janë identifikuar 24 raste në vlerë 738,786€ lidhur me të cilat fletëzotimet janë lëshuar pa u përmbushur kriteri për numrin e pro-faturave.

- Në 10 raste, në vlerë totale prej 335,516€, të cilat i përkasin periudhës pas hyrjes në fuqi të UA në vitin 2023, fletëzotimet janë lëshuar në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit, sipas të cilit kërkohet paraqitja e tre pro-faturave, si dhe
- Në 10 raste të tjera, në vlerë totale prej 258,060€, që i përkasin periudhës sa ishte në fuqi UA-03/2017, fletëzotimet janë lëshuar pa përmbushur kërkesën për bashkëngjitjen e dy pro-faturave, siç parashihej në udhëzim, si dhe
- Katër (4) raste, në vlerë totale prej 145,210€ kur lëndë me dokumentacion të pakompletuar janë proceduar për shqyrtim në Bordin për TMJISHP, i cili më pas i kishte kthyer lëndët për plotësim të dokumentacionit. Megjithatë, këto lëndë kanë mbetur të

paplotësuara dhe të pashqyrtuara, ndonëse i përkasin periudhës 2020-2021.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme efektive në procesin e lëshimit të fletëzotimeve. Gjithashtu, kufizimet kohore për lëshimin e fletëzotimeve në rastet urgjente, brenda afateve të caktuara, kishin ndikuar që procedurat e parapara të mos ndiqeshin plotësisht.

Ndikimi

Lëshimi i fletëzotimeve në mungesë të pro-faturave shkakton mos pajtueshmëri ligjore dhe mund të ndikojë në çmime më të mëdha të aprovuara për trajtime në mungesë të konkurrencës duke dëmtuar kështu buxhetin e organizatës. Procedimi i lëndëve të pakompletuara kanë ndikuar në zvarritjen e procesit të aprovimit për trajtim mjekësor të aplikuesve.

Rekomandimi B2

Bordi i Drejtues dhe Drejtori i Fondit duhet të sigurojnë respektimin e plotë të kërkesave të përcaktuara në Udhëzimet Administrative për procedurat e lëshimit të fletëzotimeve, duke u kujdesur që në të gjitha rastet të jenë të bashkëngjitura dokumentet përkatëse, përfshirë numrin e kërkuar të pro-faturave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike të detyrimeve kontigjente përmes Gjykatave dhe detyrimeve kontigjente me fletëzotime:

Çështja A1 - Mbivlerësimi i detyrimeve kontigjente që rrjedhin nga kontestet gjyqësore në PFV

Gjetja

Rregullorja Nr. 01/2017 për Raportimin Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, nenet 17 dhe 18 theksojnë se OB duhet të raportojnë në Pasqyrat Financiare Vjetore të gjitha detyrimet kontigjente, në mënyrë që pasqyrat financiare të paraqesin drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen financiare të institucionit.

Sa i përket detyrimeve kontigjente me kontest gjyqësor ishin mbivlerësuar për 26,000€:

- Në një (1) rast të kontestit gjyqësor në vlerë prej 26,000 €, Gjykata Themelore ka nxjerrë vendim refuzues ndaj padisë së palës paditëse. Nga Zyra Ligjore është konfirmuar se pala nuk ka parashtruar ankesë, rrjedhimisht regjistri i detyrimeve ishte mbivlerësuar për të njëjtën vlerë.

Mbivlerësimi i detyrimeve kontigjente ishte rezultat i mos përditësimit të regjistrit në rastet kur paditë nuk ishin proceduar më tej në instancat ankimore ose kur për to ishte nxjerrë vendim përfundimtar.

Ndikimi

Kjo ka ndikuar në regjistra të pa saktë të detyrimeve kontigjente me konteste ligjore dhe rrjedhimisht edhe në prezantimin jo të plotë të të dhënave në PFV duke ulur besueshmërinë dhe transparencën e informacionit financiar të paraqitur për palët e mundshme të interesit.

Rekomandimi A1

Bordi Ekzekutiv dhe Drejtori i Fondit duhet të sigurojnë se bëhet një rishikim dhe përditësim periodik i regjistrit të detyrimeve kontigjente, në mënyrë që të ofrohet një pamje e qartë dhe e drejtë e gjendjes financiare të organizatës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Sipas Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV), vlera e pasurive kapitale ishte 38,107€, ndërsa vlera e pasurive jokapitale ishte 454€.

Çështja A2 - Nënvlërësimi i regjistrit të pasurisë si rezultat i klasifikimit të gabuar

Gjetja Neni 22 i Rregullores Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore përcakton normat e zhvlerësimit dhe mënyrën e llogaritjes së tyre bazuar në natyrën e pasurisë.

Regjistri i pasurive kapitale ishte nënvlërësuar për shumën prej 44,325€, si rezultat i klasifikimit të gabuar të pasurive gjatë regjistrimit të tyre. Pagesat për "Sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Llogaritjes së Pagave" dhe "Aplikacionin për Menaxhimin e Tiketave", të blera në shkurt të vitit 2021, në vlerë të përbashkët prej 85,790€, ishin regjistruar dhe zhvlerësuar si pajisje të TI-së me afat zhvlerësimi prej 3 vitesh.

Megjithatë, bazuar në natyrën dhe funksionin e tyre, këto pasuri është dashur të klasifikohen si softuer (pasuri të paprekshme). Si rezultat i këtij klasifikimi të gabuar, vlera neto në libra (VNL) e pasurisë është nënvlërësuar për 44,325€.

Gabimi në klasifikim kishte ndodhur pasi pasuria ishte regjistruar duke u bazuar në kodet që FSSH kishte përdorur gjatë certifikimit të lëndës.

Ndikimi Parregullsia në klasifikim dhe në aplikimin e normave të zhvlerësimit kanë rezultuar në nënvlërësim të pasurive dhe në paraqitje jo të saktë të vlerës së tyre në pasqyrat financiare.

Rekomandimi A2 Bordi Ekzekutiv dhe Drejtori i Fondit, përmes zyrtarëve përgjegjës duhet të sigurojë rishikimin e klasifikimit të pasurive ekzistuese, në mënyrë që ato të klasifikohen sipas natyrës reale të pasurisë dhe aplikimi i normave adekuate të zhvlerësimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	10,987,998	10,761,963	10,610,293	12,637,057	22,711,153
Grante Qeveritare - Buxheti	10,987,998	10,761,963	10,610,293	12,637,057	22,711,153

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 226,034€. Kjo ulje është rezultat i kursimeve buxhetore në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve të cilat pastaj janë tërhequr me vendime të qeverisë.

Në vitin 2025 FSSH ka shpenzuar 99% të buxhetit përfundimtar ose 10,610,293€, ngjashëm si vitin paraprak.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	10,987,998	10,761,963	10,610,293	12,637,057	22,711,153
Pagat dhe mëditjet	462,998	461,963	459,206	421,295	396,198
Mallrat dhe shërbimet	500,000	275,000	246,031	240,543	223,486
Komunalitë	25,000	25,000	19,622	16,685	16,298
Subvencionet dhe transferet	10,000,000	10,000,000	9,885,434	11,958,533	22,075,171

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin ishte ulur për 1,034€. Realizimi në këtë kategori ishte 99%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 225,000€. Kjo ulje ishte si rezultat i kursimeve buxhetore në këtë kategori. Realizimi i kësaj kategorie ishte 89% e buxhetit final;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte i njëjtë si ai fillestar, pra 10,000,000€. Realizimi i subvencioneve ishte 99% e buxhetit final.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e realizuara nga FSSH në 2025 ishin në vlerë 114,536€. Ato kanë të bëjnë me kthimet e mjeteve të lira të cilat kane mbetur teprcë nga trajtimi i pacienteve neper spitale.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	105,267	105,267	114,536	888,603	57,171
Të hyrat jo tatimore	105,267	105,267			57,171
Të hyrat tjera	0	0	114,536	888,603	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024 të FSSH ka rezultuar në dy (2) rekomandime kryesore. FSSH kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, dy (2) rekomandimet e dhëna nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Bordi Ekzekutiv dhe Drejtori i Fondit, duhet të ndërmarrin hapat e nevojshëm në mënyrë që lëndët e kompletuara të trajtohen brenda afatit të përcaktuar. Për rastet tek të cilat ka paqartësi, të ndërmerren hapat e nevojshëm për sqarimin e tyre në mënyrë që të pastrohen regjistrat.	Gjatë testimit kemi vërejtur se edhe gjatë vitit 2025 ka vonesa në trajtimin e lëndëve.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori i Fondit duhet të sigurojnë respektimin e plotë të kërkesave të përcaktuara në Udhëzimet Administrative për procedurat e lëshimit të fletëzotimeve, duke u kujdesur që në të gjitha rastet të jenë të bashkëngjitura dokumentet përkatëse, përfshirë numrin e kërkuar të pro-faturave.	Gjatë testimit kemi vërejtur se edhe gjatë vitit 2025 FSSH kishte lëshuar fletëzotime me një profaturë.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Mirlinda Beqiri, Udhëheqëse e ekipit



Jehona Krasniqi Rexha, Anëtare e ekipit



Xhevat Seferi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Vonesa në ndërmarrjen e veprimeve lidhur me shqyrtimin e lëndëve nga Bordi për lëndët e kompletuara me faturë	<p>Referuar vonesave në ndërmarrjen e veprimeve lidhur me shqyrtimin e lëndëve nga Bordi për lëndët e kompletuara me faturë, sqarojmë se lëndët në fjalë janë në proces të trajtimit dhe vlerësimit në përputhje me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2023 per TMJISHP.</p> <p>Vendimmarrja për secilën lëndë do të merret pas përfundimit të procesit të vlerësimit, në pajtim me dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2023. Rrjedhimisht, lëndët janë në procedurë shqyrtimi dhe do të trajtohen në vijim sipas kritereve të përcaktuara.</p> <p>Sa i perket rasteve të hapura me vendime të Bordit për TMJISHP, vlersojmë së është e nevojshme të pasyrohet shkaku i moszekutimit të pagesve sepse kemi të bëjmë me lëndë për të cilat janë ekzekutur pagesat, por më pas kanë ndodhur kthime të këtyre pagesave për shkak të dhënave bankare të ISHP jashtë vendit. Gjithëashtu, është dashtur të pasyrohet edhe fakti që një pjesë e këtyre vendimeve nuk janë ekzekutuar për shkak të nevojës për rivlerësim.</p>	<p>Sqarimet e ofruara konfirmojnë se për lëndët e kompletuara me faturë janë evidentuar vonesa në shqyrtim dhe se një pjesë e vendimeve të Bordit kanë mbetur të pa ekzekutuara. Entiteti duhet të sigurojë që proceset e trajtimit dhe verifikimit të të dhënave bankare të realizohen brenda afateve optimale për të shmangur vonesat në vendimmarrje dhe ekzekutim. Gjetja mbetet e pandryshuar.</p>

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE PRANIMAR BËRHEDUAR: BËRHEDIMET E BËRHEDIMET DATE OF RECEIPT			
Niveli Org. Org. Unit	Shif. Klasif. Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot.	Nr. Shtypsh. Dr. Shtypsh.
05	47	1187	3



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR FOND ZA OBAVEZNO ZDRAVSTVENO OSIGURANJE COMPULSORY HEALTH	
Niveli org. Org. Unit	Nr. prot. Prot. No
FSDKSH	941
Nr. i fletës Br. i fletës	Data Datum
-03-	29/06/26

Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor / Fond za Obavezno Zdravstveno Osiguranje / Mandatory Health Care Insurance Fund

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Fondit për Sigurim të Shëndetësor, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raport");
- pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet e draftraportit dhe në nuk pajtohem për këto çështje:
 Çështja A1 - Mbivlerësimi i detyrimeve kontigjente në fletëzotim në PVF;
 Çështja B1 - Vonesa në ndërmarrjen e veprimeve lidhur me shqyrtimin e lëndëve nga Bordi për lëndët e kompletuara me faturo;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Amir Keka,
 Drejtor i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
 Data: 29 qershor 2026, Prishtinë



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.